




**Programi Zviceran për
Bashkëpunim me
Maqedoninë e Veriut
2025 - 2028**

Kontributi zviceran për një demokraci më të fortë, rritje ekonomike dhe një të ardhme më të gjelbër

Zvicra dhe Maqedonia e Veriut kanë një bashkëpunim shumëvjeçar të bazuar në respekt të ndërsjellë, interesa dhe vlera të përbashkëta.

Programi Zviceran për Bashkëpunim 2025-2028 synon mbështetjen e reformave të Maqedonisë së Veriut për integrim evropian dhe zhvillim të qëndrueshëm përmes forcimit të institucioneve demokratike, nxitjes së ekonomisë së gjelbër, rritjes së qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe promovimit të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Tema ndërsektoriale dhe parime udhëheqëse

Pronësia shtetërore

Zvicra punon në partneritet me aktorë lokalë dhe shtetërorë për ndryshime të qëndrueshme.

Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja

Qëllimi i Zvicrës është të rrisë transparencën dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje, përfshirë grupet e marginalizuara, dhe të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit. Përpjekjet e saj kontribuojnë në rritjen e besimit në institucione dhe llogaridhënien ndaj të gjithë qytetarëve.

Gratë dhe të rinjtë

Zvicra forcon kapacitetet ekonomike, sociale, mjedisore dhe politike për pjesëmarrje më të madhe të të rinjve të cilët janë ardhmëria e vendit. Ajo është e përkushtuar ndaj fuqizimit të grave si aktore kyçe për zhvillim ekonomik dhe demokratik të qëndrueshëm.

Mbrojtja e mjedisit dhe qëndrueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike

Zvicra sigurohet që programi i saj të mos dëmtojë mjedisin dhe punon për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

Fushat në fokus 2025–2028

Qeverisja demokratike dhe e mirë

Zvicra forcon kapacitetet e institucioneve publike lokale dhe shtetërore për të punuar në mënyrë më transparente, efikase dhe pjesëmarrëse, duke kontribuar kështu në përmirësimin e llogaridhënies së tyre. Mbështeten mekanizmat që promovojnë dialogun mes qytetarëve, shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore. Gjithashtu, përmirësohet njohuria e vendimmarrësve në fushat e menaxhimit të burimeve natyrore dhe ndryshimeve klimatike.

Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm

Zvicra mbështet sektorin privat, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, në rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit të burimeve, duke u përafruar me standardet evropiane. Aftësimi i fuqisë punëtore, veçanërisht i të rinjve dhe grave, me shkathtësitë e nevojshme për sektorin privat përmes arsimit dual, rikualifikimit dhe kualifikimit të mëtejshëm mbeten përparësi.

Uji dhe mjedisi


Zvicra mbështet komunat dhe ndërmarrjet publike komunale në përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë për furnizim të qëndrueshëm me ujë dhe ofrim të shërbimeve komunale, si dhe në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave përmes parimeve të ekonomisë cirkulare. Prioritete të reja janë menaxhimi i integruar i ujit dhe forcimi i komuniteteve në mbrojtjen e biodiversitetit.

Program për bashkëpunim 2025–2028

Buxheti indikativ në total:
56.1 milionë CHF

Ndarja sipas fushave të interesit:

-  Qeverisja demokratike
-  Uji dhe mjedisi
-  Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm



Rezultate të arritura 2021–2024

Kuvendi përmirësoi sistemet e tij të teknologjisë informative dhe komunikimit, duke rritur transparencën; kapacitetet e forcuara të personelit të Kuvendit përmirësuan punën e tyre.

Mbi 200 organizata të shoqërisë civile forcuuan kapacitetet për të përfaqësuar qytetarët, për të ofruar shërbime, për të avokuar për ndryshime dhe për të përmirësuar transparencën.

Mbi 1,000 këshilltarë komunalë fituan aftësi që do të ju mundësojnë të punojnë më mirë në këshillat komunalë.

Mbi 350 kompani zgjeruan biznesin e tyre në tregjet ndërkombëtare.

Startup-e dhe kompani që kanë zbatuar praktika të reja krijuan mbi 7,200 vende të denja pune.

46,000 qytetarë përfituan qasje në ujë të pijshëm me cilësi më të mirë.

Aktivitetet për digjitalizim rritën transparencën në 54 këshilla komunale dhe forcuuan besimin në rezultatet e zgjedhjeve.

300,000 qytetarë përfituan nga menaxhimi më i mirë i mbeturinave, përfshirë ndarjen dhe riciklimin.

Më shumë se 12,000 nxënës u regjistruan në arsim dual.

Më shumë se 100,000 qytetarë përfituan nga një mbrojtje më e mirë ndaj përmbytjeve, ndërsa masat e gatishmërisë u shtrinë të 300,000 persona.

Embassy of Switzerland

Maksim Gorki Street 19
1000 Skopje, North Macedonia

skopje@eda.admin.ch

<http://www.eda.admin.ch/north-macedonia>